REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR DATË 19.10.2026

Me datë 19.10.2026, u mbajt mbledhja e Këshillit Bashkiak Shkodër. Këshilltarë të pranishëm ishin: Oltion Luli, Jona Leqejza, Uarda Gjekaj, Edmond Ndou, Vjollca Petani, Fatbardh Dama, Armela Brahimi, Daniela Jakoja, Ardit Taflaj, Erald Erkoçaj, Taulant Shahmani, Erlinda Kavaja, Gjovalin Ndoj, Jurgena Bracaj, Alma Mehmetaj, Gëzim Galiqi, Gjergj Sokoli, Rezartë Pode, Lulash Nika, Ervin Brahimi, Vjoleta Perndrecaj, Ardita Spahija, Marina Duhani, Jetmira Rraboshta, Samed Bushati, Sead Jusha, Suada Kopshti, Fatmir Vojvoda, Muharrem Shkjau, Amina Lici.

Mbledhja hapet nga Kryetari i Këshillit **Z.Oltion Luli**

Kourumi i domosdoshëm është prezent në sallë, mbledhja deklarohet e hapur.
Z. Luli bën leximin e rendit të ditës.

Miratimi i Procesverbalit të Mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak datë, 24.09.2026 sipas ligjit Nr.8480 datë, 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", neni 16 pika 2.

1. *Projektvendim: "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Shtator 2026".*
2. *Projektvendim: "Mbi dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri".*
3. *Projektvendim: "Për miratimin e kërkesës për transferimin e sipërfaqes 200m² të pasurisë së shoqërisë "Tregu i shitjes me shumicë fruta - perime" sh.a tek Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural".*
4. *Projektvendim: "Për miratimin e buxhetit të vitit 2027 dhe programit buxhetor afatmesëm 2027-2029 të Bashkisë Shkodër, faza e II-të".*

5. *Projektvendim: "Për një ndryshim në VKB nr.84, datë 18.12.2025 "Për miratimin e shtesës së planit të buxhetit të vitit 2026 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër", i ndryshuar.*

6. *Projektvendim: "Për dhënien e pëlqimit për dhënien me qira të pasurisë nr. 3/159-N32 ZK 8591 me sipërfaqe 12m² ndërtesë subjektit PF Erjona Bletaj, pasuri në pronësi të Bashkisë Shkodër".*

7. *Projektvendim: "Për miratimin e kërkesës për heqjen e kushtit të përdorimit për pasurinë ish godina e gjykatës pronë e Bashkisë Shkodër dhe lejimin e dhënies në përdorim të tretëve".*

8. *Projektvendim: "Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionimit të qirasë dhe të nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë për vitin 2026".*

9. *Diskutime jashtë rendit të ditës.*

Z. Luli shton se rendit të ditës së sotme me kërkesë të Kryetarit të Bashkisë i shtohen edhe dy projektvendime:

- Projektvendim: "Për miratimin e zbatimit të projektit " Të sigurt së bashku: Aleancat e grave që udhëheqin ndryshimet për mbrojtje reale nga dhuna", në kuadër të programit CERV-2025-DAPHNE si dhe miratimin e shtesës së planit të buxhetit të Bashkisë Shkodër të miratuar me VKB nr.84, datë 18.12.2025 "Për miratimin e shtesës së planit të buxhetit të vitit 2026 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër", i ndryshuar, për realizimin e këtij projekti".

- Projektvendim: "Për miratimin e shtesës së planit dhe ndryshimit në buxhetin e Bashkisë Shkodër të miratuar me VKB nr.84, datë 18.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër", i ndryshuar,

Përpara se të kalohet tek votimi rendit të ditës dhe i procesverbalit të mbledhjes së kaluar , **znj. Uarda Gjekaj** paraqet vërejtje për procesverbalin e mbledhjes së kaluar. Ajo shprehet se në të është pasqyruar ndërhyrja e saj, por mungojnë përgjigjet e Kryetarit dhe debati lidhur me propozimin që kishte kërkuar të hidhej në votim. Kërkon plotësimin e procesverbalit me ndërhyrjet përkatëse, vënien në dispozicion të zbardhjes së plotë dhe një kopje të CD-së së mbledhjes së kaluar.
Znj. Gjekaj rikujton kërkesën për zhvillimin e interpelancës me Drejtorinë e Prokurimeve Publike për mosrealizimin e vizitës studimore në Alicante, Spanjë, në periudhën e parashikuar për muajin shtator 2026. Ajo i referohet kërkesës së protokolluar më 30.09.2026 dhe kërkon të sqarohet kujt i është përcjellë kërkesa dhe cili përfaqësues i drejtorisë është ngarkuar të marrë pjesë në interpelancë.

Kryetari sqaron se administrata ka kthyer përgjigje me email dhe se sqarimet i janë përcjellë këshilltares.
Znj. Gjekaj kundërshton kohën dhe mënyrën e kthimit të përgjigjes, duke deklaruar se e-maili është dërguar rreth një orë para mbledhjes dhe se ajo kishte kërkuar praninë e përfaqësuesve të administratës. Thekson se pyetjet lidhen me mosrealizimin e udhëtimit në shtator, ndërsa riplanifikimi i tij për muajin nëntor është çështje tjetër.
Kryetari përsërit se përgjigjja e administratës është përcjellë me email.
Lidhur me procesverbalin, Kryetari shprehet se ai përbën një përmbledhje të diskutimeve dhe se mbledhja është transmetuar drejtpërdrejt.

Vijohet me votimin e rendit të ditës së bashku me dy projektvendimet shtesë , ku rezultojnë **29** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me miratimin e procesverbalit të mbledhjes së datës 24.09.2026, ku rezultojnë **29** vota Pro **1** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Kalohet tek pika e parë e rendit të ditës: *"Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Shtator 2026"*.

Propozohet kalimi i projektvendimit drejtpërdrejt në votim, pa relatim.

Kalohet tek mendimi i Kryetarëve të grupeve, ku të gjithë shprehin dakordësi me projetktaktet.

Pr/akti i parë hidhet në votim, ku rezultojnë **30** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën 2: *Projektvendim: "Mbi dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri"*.

Kryetarët e grupeve shprehin dakordësinë që projektvendimi për dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri të kalojë drejtpërdrejt në votim, pa relatim.

Projektvendimi hidhet në votim, ku rezultojnë **30** vota pro, **0** kundër dhe **0** abstenime. **Miratohet**

Kalohet tek pika 3 *Projektvendim: "Për miratimin e kërkesës për transferimin e sipërfaqes 200m² të pasurisë së shoqërisë "Tregu i shitjes me shumicë fruta - perime" sh.a tek Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural"*.

Kryetari sqaron se projektvendimi është paraqitur sërish, pasi nuk kishte siguruar numrin e nevojshëm të votave. Ai deklaron se për miratimin kërkohen 31 vota, ndërkohë që në sallë janë të pranishëm 30 këshilltarë. Megjithatë, vijohet me hedhjen e projektvendimit në votim.

Projektvendimi hidhet në votim, ku rezultojnë **29** vota pro, **0** kundër dhe **1** abstenim. **Nuk miratohet.**

Vijohet me pikën e rradhës: 4. *Projektvendim: "Për miratimin e buxhetit të vitit 2027 dhe programit buxhetor afatmesëm 2027-2029 të Bashkisë Shkodër, faza e II-të".*

Nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore sqarohet se parashikimi i të ardhurave nuk ka ndryshuar në raport me fazën e parë të miratuar në mbledhjen e kaluar. Në vijim jepen sqarime për shtesat në transfertën e pakushtëzuar për vitet 2027–2029. Sipas relatimit, këto shtesa janë parashikuar në investimet e programit të planifikimit dhe kontrollit të territorit dhe mjedisit.

Kryetarët e grupeve shprehin dakordësinë për projektvendimin

Pr/akti i parë hidhet në votim, ku rezultojnë **29** vota Pro **0** Kundër **1** Abstenim. **Miratohet**

Kalohet tek pika 5.: *Projektvendim: "Për një ndryshim në VKB nr.84, datë 18.12.2025 "Për miratimin e shtesës së planit të buxhetit të vitit 2026 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër", i ndryshuar,*

Relaton për këtë pikë **Z.Mema**, drejtori i përgjithshëm i Zhvillimit të Qëndrueshëm Ekonomik, sipas materialit të përgatitur nga administrata. Theksohet nevoja për mbështetjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara, mbulimin e detyrave të Policisë Bashkiake, mirëmbajtjen e objekteve dhe lehtësimin e aksesit të qytetarëve në shërbime pranë njësive administrative.

Kryetarët e grupeve shprehin dakordësinë për projektvendimin.

Projektvendimi hidhet në votim, ku rezultojnë **30** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën 6.: *Projektvendim: "Për dhënien e pëlqimit për dhënien me qira të pasurisë nr. 3/159-N32 ZK 8591 me sipërfaqe 12m² ndërtesë subjektit PF Erjona Bletaj, pasuri në pronësi të Bashkisë Shkodër".*

Relaton nënkryetari i Bashkisë, **z. Alban Preka,** i cili paraqet kërkesën për marrjen me qira të pasurisë me sipërfaqe 12 m². Sipas relatimit, pasuria është e lirë dhe prej vitesh nuk përdoret për ndonjë funksion nga Bashkia. Ai paraqet bazën ligjore mbi kompetencën e Këshillit Bashkiak për dhënien e pëlqimit dhe procedurën që administrata propozon të ndjekë për dhënien me qira me afat njëvjeçar.

Znj. Uarda Gjekaj kërkon sqarime për mënyrën e informimit të qytetarëve dhe subjekteve, mungesën e një njoftimi publik dhe paraqitjen e vetëm një kërkese. Ajo kërkon të sqarohet si mund të marrin dijeni të interesuarit për pronat që jepen me qira dhe të kenë mundësi të paraqesin kërkesat e tyre.

Z. Preka sqaron se është paraqitur një kërkesë individuale dhe nuk ka pasur kërkesa të tjera. Ai deklaron se nuk është bërë njoftim publik, pasi administrata nuk e ka trajtuar këtë rast si procedurë ankandi, duke iu referuar sipërfaqes së objektit dhe afatit njëvjeçar. Shprehet se objekti ka qenë i lirë prej rreth një deri në dy vjetësh.

Në vijim, **z. Preka** informon se Bashkia ka nisur riinventarizimin e pronave dhe rishikimin e mënyrës së administrimit dhe dhënies së tyre me qira. Shprehet se, pas riinventarizimit, synohet afishimi i pronave në një faqe elektronike për informimin e të interesuarve.

Znj. Gjekaj kërkon sqarime edhe për përcaktimin e çmimit të qirasë sipas sipërfaqes dhe zonës. Z. Preka sqaron se parashikohet kryerja e një studimi dhe përcaktimi i çmimeve të reja për procedurat në vijim.

Kryetarët e grupeve shprehin dakordësinë për projektvendimin.

Projektvendimi hidhet në votim, ku rezultojnë **29** vota pro, **0** kundër dhe **1** abstenim. **Miratohet.**

Kalohet tek pika 7 e rendit të ditës: *Projektvendim: "Për miratimin e kërkesës për heqjen e kushtit të përdorimit për pasurinë ish godina e gjykatës pronë e Bashkisë Shkodër dhe lejimin e dhënies në përdorim të tretëve".*

Relaton përsëri nënkryetari i Bashkisë, **z. Alban Preka**, i cili sqaron se transferimi i ish-godinës së gjykatës është shoqëruar me kushtin e mostjetërsimit dhe të mosdhënies në përdorim të të tretëve. Propozimi lidhet me nevojën për zhvendosjen e institucionit të Prefektit të Qarkut Shkodër dhe të institucionit të Qarkut Shkodër, në kuadër të investimit "Porta e Alpeve", si dhe të Zyrës Vendore Arsimore Shkodër, në kuadër të investimit për një palestër shkollore. Sipas relatimit, ish-godina e gjykatës ka funksion administrativ, ndodhet pranë qendrës së qytetit dhe plotëson kushtet për vendosjen e këtyre institucioneve, pa pasur nevojë për investime. Z. Preka informon për korrespondencën me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Drejtorinë e Pronës Shtetërore, dhe sqaron se kërkohet vendimmarrja e Këshillit Bashkiak për vijimin e procedurës pranë Këshillit të Ministrave. Propozimi konsiston në miratimin e kërkesës drejtuar Këshillit të Ministrave për ndryshimin e pikës 3 të VKM-së nr. 376, datë 10.07.2025, lidhur me dhënien në përdorim të ish-godinës së gjykatës.

Kryetarët e grupeve shprehin dakordësinë me projektaktin.

Projektvendimi hidhet në votim, ku rezultojnë **30** vota pro, **0** kundër dhe **0** abstenime. **Miratohet.**

Vijohet me pikën tjetër: *Projektvendim: "Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionimit të qirasë dhe të nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë për vitin 2026".*

Z. Sokoli propozon kalimin e projektvendimit pa relatim. Kryetari kërkon shprehjen e qëndrimit të kryetarëve të grupeve dhe, pas dakordësisë së shprehur, vijohet me votimin.

Projektvendimi hidhet në votim, **30** vota pro, **0** kundër dhe **0** abstenime. **Miratohet.**

Vijohet me pikën e parë shtesë e rendit të ditës: *Projektvendim: "Për miratimin e zbatimit të projektit " Të sigurt së bashku: Aleancat e grave që udhëheqin ndryshimet për mbrojtje reale nga dhuna", në kuadër të programit CERV-2025- DAPHNE si dhe miratimin e shtesës së planit të buxhetit të Bashkisë Shkodër të miratuar me VKB nr.84, datë 18.12.2025 "Për miratimin e shtesës së planit të buxhetit të vitit 2026 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër", i ndryshuar, për realizimin e këtij projekti".*

Relaton **znj. Arlinda Krunja,** e cila paraqet projektin ku Bashkia Shkodër merr pjesë si partnere. Sipas relatimit, projekti financohet nga Bashkimi Europian, ka kohëzgjatje 24 muaj dhe synon forcimin e mekanizmave vendorë për mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave dhe të mbijetuarave të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Në paraqitje theksohet përmirësimi i aksesit të grave dhe vajzave në shërbime të koordinuara, gjithëpërfshirëse dhe të përshtatura me nevojat e tyre, me vëmendje edhe ndaj grave rome, grave me aftësi të kufizuara, atyre në zonat rurale dhe grupeve të tjera të margjinalizuara. Një nga komponentët kryesorë është ngritja dhe funksionalizimi i një qendre "Të sigurt së bashku" në Shkodër, sipas një modeli të integruar dhe multidisiplinar.
Znj. Kruja sqaron se Bashkia do të vërë në dispozicion ambientet e qendrës, do të sigurojë koordinimin institucional dhe do të marrë pjesë në hartimin e protokolleve, trajnimet, monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e projektit.
Gjatë shprehjes së qëndrimeve të grupeve vlerësohet puna e drejtorisë përgjegjëse. **Z. Sokoli** kërkon që projektvendime të kësaj rëndësie t'u vihen këshilltarëve në dispozicion më herët, përpara zhvillimit të mbledhjes.

Projektvendimi hidhet në votim, ku rezultojnë **29** vota pro, **0** kundër dhe **0** abstenime. **Miratohet.**

Pika e dytë shtesë e rendit të ditës: *Projektvendim: "Për miratimin e shtesës së planit dhe ndryshimit në buxhetin e Bashkisë Shkodër të miratuar me VKB nr.84, datë 18.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër", i ndryshuar,*

Edhe për këtë pike relaton **znj. Arlinda Kruja**, e cila sqaron se propozimi lidhet me të ardhurat e grumbulluara gjatë vitit për strehimin social nga kontributi që në relatim paraqitet në masën 3% të vlerës së ndërtimeve. Kërkohet pasqyrimi i të ardhurave shtesë në planin e buxhetit të Bashkisë Shkodër dhe miratimi i shtesës përkatëse në zërin e shpenzimeve kapitale të trupëzuara, sipas tabelës bashkëlidhur projektvendimit.

Kryetarët e grupeve shprehin dakordësinë për projektvendimin.

Projektvendimi hidhet në votim, **30** vota pro, **0** kundër dhe **0** abstenime. **Miratohet.**

Vijohet me diskutime jashtë rendit të ditës.

Znj. Uarda Gjekaj njofton se do të depozitojë ditën pasardhëse kërkesën për shfuqizimin dhe anulimin e vendimeve të Këshillit Bashkiak lidhur me miratimin e subjekteve që kërkojnë të njihen si posedues jopronarë. Ajo shprehet se firmat janë mbledhur, rikujton mbështetjen e shprehur në mbledhjen e mëparshme nga pesë anëtarë të Këshillit dhe kërkon shqyrtimin sipas procedurës, për t'iu paraqitur Këshillit Bashkiak për vendimmarrje.
Në vijim, ajo paraqet nismën e Aleancës së Grave Këshilltare Shkodër për organizimin e një dite në Këshillin Bashkiak kushtuar vajzave të moshës 14–18 vjeç. Nisma synon njohjen e vajzave me funksionet dhe rolin e Këshillit, krijimin e hapësirës për shprehjen e problematikave të tyre dhe përzgjedhjen e propozimeve që mund t'i paraqiten më pas Këshillit, sipas procedurave përkatëse. Ajo po ashtu deklaron se propozimi, së bashku me buxhetin orientues, do të depozitohet në sekretari ditën pasardhëse. Ajo kërkon bashkëpunimin e sekretariatit për plotësimet e nevojshme të projektvendimit dhe për vënien e tij sa më shpejt në dispozicion për shqyrtim dhe realizim.

Znj. Marina Duhani njofton se do të paraqitet me email një propozim tjetër për një paketë higjienike në ndihmë të grave dhe vajzave të Shkodrës. Ajo i referohet përvojës së Bashkisë Tiranë dhe shpreh dëshirën që kjo praktikë të ndiqet edhe në Shkodër.
Pas përfundimit të ndërhyrjeve dhe në mungesë të diskutimeve të tjera, z. Oltion Luli e deklaron mbledhjen të mbyllur.

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka. Mbledhja deklarohet e mbyllur.

Procesverbali, pasqyron në mënyrë të përmbledhur diskutimet e mbledhjes së Këshillit Bashkiak Shkodër të datës 19.10.2026. Bashkëlidhur këtij procesverbali, materiali i mbledhjes Audio.(DVD).

Procesverbali përmban 8 faqe dhe pasi lexohet, nënshkruhet pa vërejtje nga:

Sekretar

Sabina DANAJ

KRYETAR

Oltion LULI

Zbardhi Pr/verbalin:

Irma Sulishti